



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:074693

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453518

**AC-I-23-0231**

***Në ankesën e***

**Paditësi**

**S R Z**, nga fshati R, Pejë.

**Kundër**

**E paditura/Ankuesja**

**NSH. "Zastava-Ramiz Sadiku"**, (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-3605 të datës 03 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-3605 i datës 03 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 06 dhjetor 2013, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ089-0583, të datës 20 nëntor 2013, me të cilën kërkesa e tij e datës 14 tetor 2013, për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,440.00 euro, refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë ai i kundërshton vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke pohuar se në NSH "Zastava-Ramiz Sadiku", në Pejë ka punuar deri me 11 prill 2006, dhe se ka të drejtë në kompensim të pagave për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Bashkë me ankesë paditësi dërgon kopjen e Librezës së Punës e mbyllur me 11.04.2006, kopjen e ID-së për hyrje në NSH, kopjen e vendimit të Këshillit të punëtorëve të datës 14 mars 2006 dhe kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.550/06, të datës 19 mars 2007.

Me datë 2 tetor 2018, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të theksoi në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se ky Vendim nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore, prandaj nuk ka bazë të shfuqizohet. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës është e parashkruar, pasi që paditësja nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi që këto paga i ka kërkuar në afatin prej 3 vitesh. Në mbrojtje në ankesë AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 17 maj 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS lëshon një urdhër për paditësin me të cilën kërkon që të dorëzohet vendim i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 03 qershor 2021, në bazë të urdhrit të cekur, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe bashkë me këtë parashtresë e dorëzon vendimin e

Autoritetit të Likuidimit PEJ089-0583, të datës 20 nëntor 2013, si dhe kopjen e listës për të drejtën legjitime për 20%.

Me datë 03 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-13-3605, e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e shfuqizon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe e obligon të paditurën që t'ia paguaj paditësit shumën prej 1,440.00 euro, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi ka ofruar prova të mjaftuara që dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit për likuidimit e NSH-së. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të Librezës së punës dhe Listës së punëtorëve e dërguar nga AKP-ja, vërtetohet fakti se ai ka qenë punëtor i NSH-së deri me 11 prill 2006, andaj duke u bazuar në këto prova atij i është njohur e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,440.00 euro. Shkalla e I-rë konstaton se paditësi kishte 29 vite përvojë pune.

Me datë 20 prill 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-13-3605, të datës 03 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se gjetjet faktike të gjykatës së shkallës së I-rë janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Autoriteti i Likuidimit nuk e ka mohuar faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës, paditësit i është bërë për shkak të privatizimit të NSH-së. Mirëpo në këtë rast gjykata i ka ngatërruar dy afate të ndryshme, afati i parë ai për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ky afat thjesht e bën kërkesën e paditësit si të pranueshme por nuk ka të bëjë me meritat e kërkesës, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta zbatojë në kërkesën e tij, e që është afati tre vjet i parashkrimit në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës të Bashkuar. Tutje AKP-ja në ankesë konsideron se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, të cilit i referohet paditësi e informon atë se ai ka të

drejtën të parashtrojë kërkesën pranë AKP-së mirëpo nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion. Në ankesë AKP-ja pohon se kërkesa konsiderohet e parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës të Bashkuar.

Me datë 16 qershor 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen në ankesën e AKP-së. Në përgjigjen në ankesë, paditësi i ka kundërshtuar si të pabazuara pretendimet ankimore të AKP-së, dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm dhe i bazuar në prova të vlefshme. Tutje në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pretendimet për shkelje të dispozitave të procedurës dhe pretendimet për zbatim të gabuar të dispozitave materiale. Në këtë parashtresë paditësi pohon se gjykata me të drejtë e ka aprovuar shumën prej 1,440.00 euro në emër të kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, pasi që ka sjellë prova që me veprimin e AKP-së atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 14 tetor 2013, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit ndaj NSH "Zastava - Ramiz Sadiku", (në likuidimi) Pejë, dhe kërkon kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,440.00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si të pa vlefshme nga

Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e shfuqizon Aktgjykimin e ankimuar dhe e detyron të paditurën t'ia paguaj paditësit që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,440.00 euro, duke u bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë përveç vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit ai ka dërguar në Gjykatë, kopjen e Librezës së Punës e mbyllur me 11.04.2006, kopjen e vendimit të Këshillit të punëtorëve të datës 14 mars 2006 dhe kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.550/06, të datës 19 mars 2007.

Bazuar në këto dëshmi si dhe në faktin që edhe AKP-ja me mbrojtjen në ankesë të dorëzuar me datë 02 tetor 2018, nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, me të drejtë Shkalla e I-rë e DHPGJS e ka aprovuar ankesën e paditësit që atij ti paguhen 6 paga në shumë prej 1,440.00 euro, bazuar në përvojën e tij të punës, prej 29 viteve.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 06 qershor 2023, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_